

Lista e dokumenteve të sugjeruara të Fair Fares NYC (Albanian)

Aplikimi për Fair Fares është kaq i lehtë sa mund mos t'ju duhet të dorëzoni ndonjë dokument! Nëse po, lista e mëposhtme do t'ju ndihmojë t'i zgjidhni ato dokumente. Aplikimi online do t'ju udhëzojë se çfarë duhet të dorëzoni kur të plotësoni aplikimin.

■ Për të verifikuar **IDENTITETIN** dhe **MOSHËN**, përdorni **NJËRIN** nga dokumentet e mëposhtme:

-
- Dokument identifikimi me fotografi të lëshuar nga qeveria (p.sh. NYS ID, IDNYC)
 - Leje drejtimi nga cilido shtet
 - Pasaportë nga cilido shtet
 - Dokument identifikimi me fotografi, i skaduar dhe që është lëshuar nga shteti deri përpara 3 vitesh
 - Dokument identifikimi i shërbimit ushtarak amerikan
 - Dokument identifikimi klanor
 - Kartë regjistrimi USCIS/Kartë e përhershme e shtetësisë/Leje e përhershme qëndrimi (Green Card)/Certifikatë natyralizimi
 - Dokumente birësimi
 - Certifikatë lindjeje
 - Dokument identifikimi i autorit të veprës penale të liruar nga Departamenti i Administrimit të Burgjeve dhe Mbikëqyrjes së Komunitetit të shtetit të Nju-Jorkut deri përpara 3 vitesh

Shënim: Mund të përdoren edhe dokumente të tjera. Dokumentet duhet të tregojnë emrin dhe datëlindjen tuaj.

■ Për të verifikuar **VENDBANIMIN**, përdorni një faturë, deklaratë ose dokument të lëshuar nga qeveria në 90 ditët e fundit:

-
- Faturë të shërbimeve kabllore, telefonit ose shërbimeve utilitare
 - Çdo kontratë qiraje në emrin tuaj për vendbanim në qytetin e Nju-Jorkut
 - Konfirmim i ndryshimit të adresës nga Shërbimi Postar i Shteteve të Bashkuara (USPS)
 - Faturë qiraje
 - Pasqyrë bankare
 - Faturë e sigurimeve (sigurim i shëndetit, i pronarit të shtëpisë, i qiramarrësit, i jetës ose i automjetit)
 - Faturë ose deklaratë e kartës së kreditit

Shënim: Mund të përdoren edhe dokumente të tjera që vërtetojnë vendbanimin brenda 90 ditëve të fundit.

(Ktheni faqen)

■ Për të verifikuar **TË ARDHURAT E TATUESHME TË FAMILJES**, përdorni dokumentet e mëposhtme:

- Të gjitha faqet e Formularit 1040 të Shërbimit për të Ardhurat e Brendshme (IRS) nga viti i kaluar

Ose për ju dhe secilin pjesëtar të familjes përdorni të gjitha opsionet e vlefshme:

- Përfitimet për personat me aftësi të kufizuara nga NYS: Vërtetim i përfitimeve ose fletëpagesë çeku
- Përfitimet e pensionit: Deklaratë ose fletëpagesë çeku
- Përfitimet nga SSI/SSA: Certifikatë/letër shpërblimi aktuale ose çek aktual i përfitimit ose korrespondenca nga SSA-ja
- Përfitimet e sigurimit për papunësinë: Certifikatë e shpërblimit aktual ose korrespondenca zyrtare me Departamentin e Punës së Shtetit të Nju-Jorkut
- Vërtetim pagese nga qiramarrësi (kopje e çekut/urdhërpagesës) ose deklaratë me shkrim e të ardhurave të marra prej qirasë
- Të gjitha fletëpagesat për 30 ditët e fundit
- Letër nga punëdhënësi - e nënshkruar dhe e datuar që tregon të ardhurat bruto për 30 ditët e fundit; përfshini emrin, adresën dhe numrin e telefonit të punëdhënësit
- Pasqyrë bankare nëse pagesa është depozituar në llogarinë tuaj
- Dokumentacion vetëpunësimi: të dhënat e biznesit ose të dhënat tatimore
- Nëse asnjë nga të mësipërmet nuk është e disponueshme, jepni një letër nga ju, të nënshkruar dhe të datuar, që tregon të ardhurat bruto për 30 ditët e fundit; duke përfshirë përshkrimin e të ardhurave

Shënim: Të ardhurat nga mbështetja financiare për fëmijën nuk duhet të përfshihen në llogaritjen apo në aplikimin ose dokumentacionin tuaj.

Telefononi në numrin 311 nëse keni ndonjë pyetje për këtë njoftim. Gjithashtu, mund të vizitoni faqen nyc.gov/fairfares për më shumë informacion në lidhje me programin Fair Fares NYC.